REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr._____ Prot.

Kavajë, më ____.____.2026

PROJEKT-VENDIM

Datë _____._____. 2026

"PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË KAVAJË DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E TIJ"

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të nenit 29 "Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike", Ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, Ligjit Nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit" i ndryshuar, VKM Nr.678, datë 30.10.2024 "Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendore të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar për sigurinë në komunitet", sipas shkresës së Prefektit të Qarkut Tiranë, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me miratimin e Kryetarit të Bashkisë, i propozojmë Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e tij të rradhës,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e krijimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Kavajë dhe rregulloren për organizimin dhe funksionimin e tij, sipas dokumentit bashkëngjitur.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Adrian Malaj

DREJTORIA LIGJORE
Helidon Plaku

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
Meri Biturku

K R Y E T A R I
FISNIK QOSJA

RREGULLORE
PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË KAVAJË

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj Rregullore është përcaktimi i përbërjes, detyrave, përgjegjësive, mënyrën e funksionimit të Këshillit Vendor për Siguri ngritur pranë Bashkisë Kavajë.
Ky është një organ konsultues për çështje të sigurisë, që në bashkëpunim me policinë dhe institucione të tjera sigurie shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë, në të mirë të komunitetit të Bashkisë Kavajë.

Neni 2
Baza ligjore

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 29;
Ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar;
Ligji nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar;
Ligji nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike"
Ligji nr.103/2014 "Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë"
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.678, datë 30.10.2024 "Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendor të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet";
VKM nr.930, datë 18.11.2015 "Për mitatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizimit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit";
Deklarat Universale e të Drejtave të Njeriut;
Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Neni 3
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave që zbatohen për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) pranë bashkisë. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike (KVSP) funksionon si një organizëm koordinues, identifikues dhe konsultues pranë bashkisë mbi problematikat që lidhen me sigurinë e komunitetit për cështje të rendit dhe sigurisë publike. KVSP nuk ushtron veprimtari me interes ekonomik dhe për këtë arsye nuk ka buxhet të veçantë. Qëllimi i KVSP është të kontribuojë në rritjen e sigurisë publike si një organ këshillimor në bashki nëpërmjet:
-Identifikimin e problemeve në lidhje me sigurinë dhe rendin publik
-rritjes së ndjenjës së sigurisë
-nxitjes së angazhimit të komunitetit në çështjet e sigurisë publike
-identifikimit të pikave të nxehta përsa i përket situatës kriminale, aksidenteve në qarkullimin rrugorsjelljeve anti-shoqërore dhe kundravajtjeve dhe marrjen e masave për zbutjen e këtyre rreziqeve

-hartimin e rekomandimeve dhe aktiviteteve për rritjen e sigurisë dhe rendit public drejtuar autoriteteve përgjegjëse për identifikimin e çështjeve që paraqesin rrezik për sigurinë dhe rendin publik
-diskutimin e raporteve dhe të dhënave lidhur me sigurinë në bashki dhe identifikimin e masave për adresimin e problemeve
-hartimi dhe/ose dhënia e informacioneve mbi Planet e Veprimit për Sigurinë Publike
-komunikimi dhe informimi i vazhdueshëm i institucioneve përgjegjëse për sigurinë publike dhe sociale mbi problematikat e identifikuara dhe elementët e tjerë të lidhur me sigurinë publike.

Neni 4
Përbërja

Këshilli Vendor për Siguri Publike përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

a) Kryetar i Bashkisë
b) Shefi i Komisariatit të Policisë
c) Drejtor i Policisë Bashkiake
d) Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar
e) Drejtues i Emergjencave Civile në bashki
f) Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror
g) Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
h) Përfaqësuesi i Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor
i) Përfaqësuesi i Agjencisë Rajonale të Mjedisit
j) Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar i Ushqimit
k) Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Zonave të Mbrojtura
l) Koordinatori Vendor për Referimin dhe Menaxhimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare
m) Përfaqësuesi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve
n) Kryeinspektori i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit
o) Përfaqësuesi i Agjencisë së Mbrojtjes së Kunsimatorit

Në varësi të temave të rendit të ditës, Kryetari i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike mund të ftojë në mbledhjet e tij përfaqësues nga:

a) Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm
b) Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm
c) Komunitetet fetare
d) Organizatat e shoqërisë civile (organizatat rinore, të grave, të bizneseve, të oakicave kombëtare, të mediave lokale, të universiteteve), të komunitetit, sipas rastit
e) Këshilli Vendor i Rinisë
f) Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit
g) Shoqatat e njësive të vetëqeverisjes vendore
h) Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut
i) Shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve.

Neni 5
Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Këshillit të KVSP-së

1. Ndërrmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike.
2. Organizon mbledhjet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, minimalisht 1 (një) herë në 3 (tre) muaj ose sa herë vlerësohet e nevosjme nga anëtarët e tij.

3. Propozon për vendimmarrje në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike detyra dhe masa konkrete, sipas përgjegjësive institucionale për zbatimin e prioriteteve për çështjet e rendit dhe sigurisë në komunitet.
4. Harton, konsulton, miraton, ndjek dhe raporton planin vjetor të punës, sipas masave të palnit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet.
5. Përfaqëson Këshillin Vendor të Sigurisë Publike në marrëdhëniet me të tretët, duke përfshirë bashkëpunimet me organizmat ndërkombëtarë dhe ata vendas.
6. Fton në mbledhjet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike përfaqësuesit e institucioneve, sipas pikës 4 të VKM Nr.678, datë 30.10.2024 "Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendore të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar për sigurinë në komunitet".
7. Zhvillon forumet e hapura konsultative me qytetarët për identifikimin dhe evidentimin e problematikave, lidhur me sigurinë në komunitet.

Neni 6
Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike

1. Angazhohet për parandalimin, minimizimin e rreziqeve dhe kërcënimeve në çështjet që cënojnë sigurinë në komunitet;
2. Mbikqyr dhe zbaton planin vjetor të punës, sipas masave të planit të veprimit të stratgjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet;
3. Indetifikon, analizon dhe vlerëson problematikat lidhur me sigurinë në komunitet dhe i trajton ato në mbledhjet e këshillit;
4. Propozon zgjidhje për problematikat e rasteve konkrete tek autoritetet kopeytente shtetërore,pjesëmarrëse ose jo në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike;
5. Identifikon prioritetet në fushën e sigurisë në komunitet dhe rekomandon përfshijen e tyre në mbledhjen e radhës;
6. Propozon dhe vlerëson detajet e veprimtarisë së institucioneve përgjegjësie për sigurinë publike në komunitet dhe ia komunikon ato drejtuesve të tyre;
7. Kontrubon dhe siguron pjesëmarrje në aktivitetet ndërgjegjësuese për komunitetin edhe përmesa projekteve për çështjet e sigurisë në komunitet;
8. Vendos me shumicën e votive të të gjith anëtarëve të tij;
9. Merr në shqyrtim përmbushjen e rekomandimeve për çështjet e trajtuara në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike;
10. Përcakton përbërjen e sekretariatit teknik.

Neni 7
Detyrat e sekretariatit teknik

1. Përgjigjet për mbarvajtjen e veprimtarisë së këshillit vendor nga ana logjike dhe administrative;
2. Mban, ruan dhe përditëson të gjitha kontakteve e anëtarëve të këshillit;
3. Organizon dhe bën koordinimin e mbledhjeve të këshillit;
4. Njofton anëtarët për mbledhjen e radhës;
5. Përgatit materialet përkatëse paraprake të mbledhjes, sipas rendit të ditës për anëtarët;
6. Merr pjesë në mbledhjet e këshillit, duke mbajtur minutat e takimit;
7. Shkëmben informacionin dhe materialet e mbledhjes midis anëtarëve;
8. Harton provesverbalet e mbledhjes dhe raportet;
9. Mban listën e pjesëmarrësve të pranishëm në mbledhje;
10. Protokollon dhe mban arkivin e procesverbaleve të mbledhjeve;

11. Kontrollon adresën elektronike, si mjet të komunikimit elektronik të këshillit;
12. Përgatit dhe bën publikimin e njoftimeve apo materialeve të ndryshme për publikun.

Neni 8
Mbledhjet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike zhvillon mbledhjet, në bazë të rendit të ditës, të miratuar nga kryetari dhe anëtarët, sipas procedurës së mëposhtme:

1. Njoftimi për datën e zhvillimit të mbledhjes dërgohet të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së përcaktuar me shkresë zyrtare ose në formë elektronike, për të cilën anëtaret kanë rënë dakord;
2. Anëtarët njoftohen paraprakisht edhe për rendin e ditës edhe për çdo informacion tjetër të nevojshëm;
3. Në përcaktimin e çështjeve të rendit të ditës mund të kontribuojnë edhe anëtarët;
4. Propozime për rendin e ditës mund të dërgohen edhe përmes adresës elektronike nga çdo qytetar;
5. Mbledhjet mbahen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të përhershëm të këshillit. Në rast kur ky numër nuk plotësohet, mbledhja shtyhet në një datë tjetër, por jo më vonë se 3 (tri) ditë pune;
6. Në mbledhjet me anëtarësi më të vogël pjesëmarrësish mund të diskutohen çështje, por nuk mund të merren vendime pa kuorumin e nevojshëm;
7. Mbledhja hapet dhe drejtohet nga kryetari, i cili bën prezantimin e rendit të ditës, si dhe një përmbledhje të zhvillimeve të fundit të punës së këshillit;
8. Kryetari drejton diskutimin, përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës;
9. Anëtarët diskutojnë në bazë të rendit të ditës dhe raportojnë për detyrat;
10. Në mbledhje shqyrtohen me hollësi të gjitha problemet dhe çështjet e parashtruara, sipas rendit të ditës, por anëtarët kanë të drejtën e propozimit për të diskutuar edhe çështje të tjera;
11. Në përfundim të mbledhjes, mbahet procesverbal nga sekretariati teknik, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët dhe kryetari;
12. Në procesverbal mbahet shënim lista e pjesëmarrësve në mbledhje, si dhe emrat e anëtarëve që nuk kanë marrë pjesë, të cilët duhet të njoftojnë me shkrim për arsyet e mospjesëmarrjes;
13. Këshilli vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij;
14. Pas çdo mbledhje, publiku informohet përmes një njoftimi në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse për datën e mbledhjes, pjesëmarrjen, çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës dhe përmbledhjen e diskutimeve;
15. Publikimi i njoftimit bëhet Brenda 3 (tri) ditëve punë nga zhvillimi i mbledhjes.

Neni 9
Vendimet

1. Vendimet e marra në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike dërgohen pranë prefektit të qarkut, brenda 3 (tri) ditëve punë nga marrja e tyre.
2. Prefekti i qarkut, pas çdo vendimi të marrë nga Këshilli Vendor i Sigurisë Publike, informon Këshillin Kombëtar të Sigurisë në Komunitet.

Neni 10
Rregullat e mbledhjes

1. Anëtarët e Këshillit, nuk duhet ta ndërpresin fjalën e kryesuesit të mbledhjes ose të diskutuesve të tjerë, të përdorin fjalë ofenduese, të ndërmarrin sulme personale apo veprime ndaj ndonjë anëtari, të përhapin informacione që cenojnë jetën private të çdo anëtari, të sillen në mënyrë të padenjë ose të shkaktojnë rrëmujë në mjediset ku mbahet mbledhja e KVSP-së.

Neni 11
Masat disiplinore

Masat disiplinore që mund të ndërmeren për anëtarët që shkelin nenin 9 të këtij akti janë:
a. Tërheqje e vëmendjes;
b. Vërejtje;
c. Marrja e fjalës;
d. Përjashtim nga seanca e mbledhjes.

Neni 12
Gjuhët e përdorura

Mbledhjet e Këshillit mbahen në gjuhën shqipe, duke siguruar përkthimin e përshtatshëm, sipas nevojës edhe në gjuhët e komuniteteve tjera.

Neni 13
Dispozitat kalimtare

1. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë Rregullore do të bëhen sipas procedurës së nxjerrjes së saj.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Bashkiak Kavajë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA LIGJORE

Nr._____ Prot. Kavajë, më ____.____.2026

RELACION

"PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË KAVAJË DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E TIJ"

I paraqesim Këshillit Bashkiak Kavajë këtë relacion për të kërkuar miratimin e krijimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.678, datë 30.10.2024 "Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendor të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet".

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike funksionon si një organizëm koordinues, identifikues dhe konsultues për problematikat që lidhen me cështjet e rendit dhe sigurisë në komunitet.

Këshilli përbëhet nga përfaqsues të institucioneve publike, por në mbledhjet e tij mund të ftohen përfaqësues të institucioneve gjyqsore, përfaqësues të komuniteteve fetare, organizatat e shoqërisë civile, shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve etj.., nga ku kërkohet përgjegjësi qytetare, përgjegjësi institucionale për adresimin e problematikave dhe zgjidhjen e tyre sipas tagrit që secili institucion ka. Synimi kryesor i Këshillit është të vërë në lëvizje te gjithë aktorët vendor për të trajtuar së bashku cështjet që lidhen me kriminalitetin, dhunën në familje dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Po ashtu, ky grupim këshillimor, që kryesohet nga kryetari i bashkisë do të shërbejë për të indentifikuar sfidat e komunitetit vendor sa i takon sigurisë personale. Gjithashtu një qëllim i rëndësishëm është edhe vendosja e një bashkëpunimi të qëndrueshëm mes gjithë aktorëve vendor, përfshirë shoqërinë civile, policinë, shërbimet sociale etj.

Pas marrjes dijeni të VKM-së, bashkia kavajë ka ndërrmarrë menjëherë hapat për ngritjen e KVSP-së duke kërkuar nga institucionet e përcaktuara në pikën 2 të vendimit, caktimin e përfaqësuesve të tyre.

Janë marrë konfirmimet përfundimtare nga të gjithë institucionet përbërëse të KVSP-së, si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni	Institucioni	Nr.Tel.	E-mail
1	Fisnik Qosja	Kryetar i Bashkisë	Bashkia Kavajë		

2	Leonard Lalaj	Shef i Komisariatit të Policisë Kavajë	Drejtoria Vendore e Policisë Durrës	0693080806	
3	Alban Sharra	Drejtor i Policisë Bashkiake	Bashkia Kavajë	0693248163	policiabashkiake@bashkiakavaje.gov.al
4	Enver Biturku	Drejtor në Zyrën Vendore Arsimore Kavajë	Zyra Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës	0694074645	enver.biturku@arsimi.gov.al
5	Ibrahim Skuqi	Drejtor i Emergjencave Civile	Bashkia Kavajë	0697871465	
6	Eleni Pistoli	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë	Shërbimi Social Shtetëror	0676076177	eleni.pistoli@sherbimisocial.gov.al
7	Megi Laska	Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor	Drejtoria Rajonale Tiranë	0693055225	Megi.Laska@oshksh.gov.al
8	Klodian Shehi	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor	Bashkia Kavajë	0682055805	Klodian.Shehi@oshksh.gov.al
9	Ermal Arapi	Drejtor i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër	Agjencia Kombëtare Mjedisit	0682007561	ermal.arapi@akm.gov.al
10		Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit			
11	Albion Kadiu	Drejtor i Administratës së Z.M Tiranë	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura	0686699999	Albion.Kadiu@akzm.gov.al
12	Jasmina Ferati	Koordinatori vendor për referim dhe menaxhim të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare	Bashkia Kavajë	0692330333	Jasminaferati1@gmail.com
13	Melina Boria	Përfaqësuesi njësisë për mbrojtjen e fëmijëve	Bashkia Kavajë	0675673278	Melinaboria1@yahoo.com
14	Mehmet Reçi	Kryeinspektor i IMTV	Bashkia Kavajë	0693103131	Mehmet.Reci@bashkiakavaje.gov.al
15	Enisa Xhaferaj	Agjencia Mbrojtjes së Konsumatorit	Bashkia Tiranë	0684791636	erisa.xhaferaj@tirana.al

❖ ***Shënim: për të siguruar fleksibilitetin dhe funksionimin e pandërprerë të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) është parashikuar që në rast se ndodh ndryshim i përfaqëuesit të ndonjë institucioni antëar, ky ndryshim të mos kërkojë vendimmarrje të re nga Këshilli Bashkiak. Në këtë rast, institucioni përkatës do të njoftojë zyrtarisht Bashkinë Kavajë për përfaqësuesin e ri, duke ruajtur përbërjen institucionale të këshillit siç është miratuar në këtë vendim.***

Referuar nenit 29 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, "Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike", bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e mbarvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet, parandalimin e kundëvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njësive të vetqeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor, në mbështetje të VKM nr.678, datë 30.10.2024 "Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendor të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet", ***paraqitet ky relacion shoqërues i projekt vendimit për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Kavajë.***

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

DREJTORI
HELIDON PLAKU